



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 73 , datë 27. 12. 2022

**MIRATIM I PAKETËS FISKALE VITI 2023 PËR BASHKINË
RROGOZHINË**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 27. 12. 2022 analizoi dhe mori në shqyrtim Projektvendimin e ardhur nga Bashkia, me shkresë Nr.5168. Prot, datë 19.12.2022 “Paketa Fiskale viti 2023 Bashkia Rrogozhinë” .

Në mbështetje të gërmës “F” të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore“. Bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar ; Ligjin nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar .ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;Ligjit nr . 142/2015 dt.17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 9632 dt . 30.10.2006“Për sistemin e taksave vendore”Ligjit nr.106/2017 dt.30.11.2017 “Taksa mbi pasuritë e paluajtshme” VKM – së Nr.132. dt .7.3.2018 ligjit nr. . 107/2015, date 31.07.2015, “ Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” ; VKM- së Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e proçedurace dhe kushteve për dhënien e Licencës për tregtimin e naftës bruto dhe n/produkteve të saj” Ligjit Nr.8378 dt 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”; Ligjit nr. 8450, datë 18.03.1999 “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre”; Ligjit nr.9723 “Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar;; Ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të gjitha akteve të tjera nënligjore për zbatimin e ligjeve të sipërcituara, me propozim të Kryetarit të Bashkisë , Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

TË MIRATOJË PAKETËN FISKALE PËR VITIN 2023 BASHKISË RROGOZHINË , si më poshtë vijon :



Reforma territoriale e aplikuar në vitin 2015, solli ndryshime edhe për kufijtë territorialë të Bashkisë Rrogozhine, duke përfshirë brenda saj territore tërësisht të ndryshme nga përbërja administrative, kulturore, sociale etj. Lidhur me këto ndryshime, lindi domosdoshmëria e krijimit të raporteve ndërmjet zonave në fushat e ndryshme administrative, në ruajtjen e këtyre traditave, territoreve produktive në aspektin bujqësor, në ruajtjen dhe mirëadministrimin e pyjeve, kullotave etj. Gjithashtu, për të qenë sa më pranë banorëve si dhe për të krijuar mundësi të barabarta të përfitimit të shërbimeve publike, u studiuan me prioritet llojet dhe nivelet e taksave dhe tarifave . Tashmë Bashkia Rrogozhine në tërësinë e saj, është përkushtuar për arritjen e objektivave për realizimin e të ardhurave si dhe në shpërndarjen sa më të drejtë të buxhetit për çdo NJ/A , sipas Ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", **Bashkia Rrogozhinë kufizohet gjeografikisht nga lindja me Bashkinë Tiranë, në Perëndim nga deti Adriatik, në veri nga Bashkia Kavajë dhe në jug nga Bashkia Lushnjë. Bashkia Rrogozhinë ka një sipërfaqe prej 223.5 km² tokë me një vijë bregdetare prej 15 Km. Përbëhet nga Qyteti Rrogozhinë dhe 4 Njësi Administrative që janë Nj/A. Gosë, Lekaj, Kryevidh dhe Sinaballaj me një numër prej 39 fshatrash. Numri i familjeve për Bashkinë është 11.292 dhe me popullsi 42.506 banorë.**

Nr.	NJËSI ADMINISTRATIVE	LAGJE / FSHATRA
1	Njësia Administrative Rrogozhinë	Lagja Nr.1, Lagja Nr.2, Kodër, Çetë, Përparim, Poligon, Stacioni Trenit, Shimëve, Çamëve.
2	Njësia Administrative Gosë	Gosë Qendër, Kërçukaj, Gosë e Madhe, Gosë e Vogël, Kalush, Ballaj, Vilë Bashtovë.
3	Njësia Administrative Lekaj	Luz i Madh, Shkozë, Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Gërmej, Okshun, Zanbishe, Mushnikë, Mlik.
4	Njësia Administrative Kryevidh	Domen, Kazie, Spanesh, Stërbeg, Spille, Greth, Shardushk, Kryevidh, Rreth Greth, Ballaj, Zhabjak, Patk Milot.
5	Njësia Administrative Sinaballaj	Sinaballaj, Hasdushk, Met'hasanaj, Hamenraj, Koçaj, Thartor, Rrostej, Fliballie, Demarke.

Procesi i Hartimit të Paketës fiskale

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Rrogozhine.

- Drejtoria e Financës dhe e Shërbimit Social
- Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik
- Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe e Marrëdhënieve me Publikun
- Drejtoria e Politikave Urbane
- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
- Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve



- Inspektoriat Vendor i Mbrojtjes së Territorit
- Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës dhe Sportit
- Gjendja Civile
- Policia Bashkiake
- Administratorët e Njësive Administrative

Hartimi i Paketës Fiskale 2023 kaloi nëpërmjet etapave si më poshtë:

Ngritja e grupit të punës për hartimin e paketës fiskale të integruar

Përcaktimi i bazës ligjore dhe prioritetëve strategjike të zhvillimit

Konsultimi i propozimeve të paketës fiskale me banorët në çdo njësi administrative dhe grupeve të interesit, bizneset, etj.

Hartimi i draftit të paketës fiskale dhe miratimi nga këshilli i bashkisë

Publikimi i paketës fiskale

Konsultimi me qytetarë dhe grupe interesi në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë Rrogozhine janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh (juridik) dhe të vogël (fizik), banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë. (Përmbledhje e organizimit të takimeve dhe propozimeve qytetare janë bashkëngjitur këtij Vendimi).

Çfarë prezanton paketa fiskale?

Prezanton propozimet për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qenë në linjë dhe në zbatim me prioritetet e Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Rrogozhinë dhe Planit të Zhvillimit të Territorit. Propozimet konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale, për përgatitjen e një pakete fiskale të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë. Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

a) Hartimin e një pakete fiskale të integruar;

b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësi vendore duhet të arkëtojë të ardhura;

c) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësive për çdo taksë dhe tarifë, pjesë e kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent;

d) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët:

- Taksim i drejtë;
- Tarifim mbështetur në kosto;
- Klasifikim i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit;
- Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;



Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësi (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji;

e) Rikategorizimi dhe detajimi i taksave;

f) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësi (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifatat, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;

g) Aplikimi i lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, siç parashikon ligji.

Kuadri ligjor dhe nënligjor

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësisë të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Bazuar në Ligjin Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" dhe Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në të ardhurat vendore përfshihen kryesisht:

Tatimi i thjeshtuar mbi BV;

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- Taksa e pasurisë;
- Taksa për transferimin e pasurisë së patundshme;
- Taksa për automjetet/mjetet e përdorura;
- Taksa e zënies së hapësirave publike;
- Taksa e tabelës/reklammat;
- Taksa të përkohshme;
- Tarifa për shërbime;

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

Ligje:

- Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar me Ligjin nr. 9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr. 10354 , datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt. 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015;



- Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar me Ligjin nr. 9483, datë 16.2.2006, ndryshuar me Ligj Nr. 9632, datë 30.10.2006; ndryshuar me Ligjin nr. 9716 datë 16.04.2007; ndryshuar me Ligjin Nr. 9735 datë 17.05.2007; ndryshuar me ligj nr. 9766 datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9804 datë 13.09.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9844 datë 17.12.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9943, datë 26.6.2008; ndryshuar me Ligjin nr.10072, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr.10228, datë 4.2.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010; ndryshuar me Ligjin Nr. 20/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me Ligjin nr. 71/2012, datë 28.6.2012; ndryshuar me Ligjin Nr. 122/2012, datë 20.12.2012; ndryshuar me Ligjin Nr. 107/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 124/2013, datë 25.4.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 177/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 32/2014, datë 3.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 42/2014, datë 24.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 156/2014, date 27.11.2014;
- Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”;
- Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, ”Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar me Ligjin Nr.10 065, datë 29.1.2009, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 131 date 11.5.2009, ndryshuar me Ligjin nr. 10145, datë 28.9.2009, ndryshuar me Ligjin nr.10280, dt.20.5.2010, ndryshuar me Ligjin Nr. 10458, datë 21.7.2011 ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2012, datë 13.9.2012 ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2013, datë 18.04.2013, ndryshuar me Ligjin Nr. 178/2013, datë 28.12.2013, ndryshuar me Ligjin Nr. 86/2014, datë 17.07.2014, ndryshuar me Ligjin Nr. 157/2014, datë 27.11.2014;
- Ligji nr. 93/2015 “Për turizmin”;
- Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;
- Ligji Nr 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji Nr.10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
- Ligji. Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”;
- Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”;
- Ligji Nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar me Ligjin Nr.9561, datë 12.6.2006 dhe LigjinNr.9797, datë 23.7.2007;
- Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
- Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;



- Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- Ligji Nr.106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9632,date 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave vendore” i ndryshuar.

Vendime dhe udhëzime:

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 505, datë 1.8.2007 “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, ”Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.7, datë 4.01.2012, "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare", i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 970, dt 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” ; □ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 21.6.2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 632 datë 11.06.2009 “Për tarifatat në sektorin e Kullotave”,
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. nr.1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 992, datë 9.12.2015 “Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.469, datë 3.6.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore";
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 285, date 27.6.2002 “Për tarifatat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1108, date 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.132,date 7.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “NDËRTEESA”, e bazës së taksës për kategori specifike,natyren dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës , si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.



- Udhëzim i Ministrisë të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”;
- Udhëzim i Ministrisë të Financave Nr.32, datë 31.12.2013, "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar.
- Udhëzim i Ministrisë të Financave Nr.26, datë 4.09.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar.
- Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore”;
- Udhëzim i Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6756, datë 3.9.2015 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apokontra-ta të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar;
- Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", I ndryshuar;
- Udhëzuesi i Ministrisë për Çështjet Vendore nr 541/1, date 31.12.2015 “Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 dat.30.12.2015 "Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme”;

1.TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

- **Baza Ligjore:** Ligji Nr.8438 dt.28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni Kreu III. Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar Kreu III, neni 10,11,12,13,14,15,16,17,18,19.
- **Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tatimit:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.
- **Administrata Tatimore Qendrore** transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ose të komunave, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet dhe për shërbimin që kryen merr një komision, i cili është në masën 1 (një) për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore.
- **Struktura përgjegjëse për kryerjen e akt-rakordimeve:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore është përgjegjëse për rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore, Durrës.

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me mbi 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

- **Baza e taksës/tatimi:** Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, llogariten



në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, paraqitet si më poshtë vijon :

Tabelë 1. Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Shkalla Tatimore	Njësia	Shkalla Tatimore	
		Nj.A Rrogozhinë	Nj.A të tjera
A.Me qarkullim vjetor 0 – 14.000.000 lekë	lekë/vit	0	0
B.Me qarkullim vjetor mbi 14.000.000 lekë	lekë/vit	15% e fitimit	15% e fitimit

Mënyra e pagesës: Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 Prill, për muajt: Janar, Shkurt e Mars; brenda datës 20 Korrik, për muajt: Prill, Maj e Qershor; brenda datës 20 Tetor, për muajt: Korrik, Gusht e Shtator; dhe brenda datës 20 Dhjetor, për muajt: Tetor, Nëntor dhe Dhjetor.

2.TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

- **Baza Ligjore:** Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 20,21. VKM-së Nr.132 datë7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa” e bazës së taksës si dhe kriterëve dhe rregullave për vlerësim alternativ të detyrimit të taksës”.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

• Në taksën mbi pasuritë e paluajtshme përfshihen:

a) Taksa mbi ndërtesat.

b) Taksa mbi tokën bujqësore.

c) Taksa mbi truallin.

• Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.



- Këshilli Bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në kufijtë plus-minus 30 % (tridhjetë përqind) të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.
- Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësisive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 % (tridhjetë e pesë përqind), krahasuar me çmimin e zonës më të afërt përjashtuar zonat rezidenciale.

2a.TAKSA MBI NDËRTESEN

- **Baza Ligjore:** Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, pikat 1,2,3,4,5 të nenit 22. VKM-së Nr.132 datë7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa” e bazës së taksës si dhe kriterëve dhe rregullave për vlerësim alternativ të detyrimit të taksës”
- **Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat është Zyra e Tksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhinë si dhe zyrat e taksave pranë Njësisive Administrative.**
 - a. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj,të cilët janë pronarë apo përdorues ndërtesash në territorin e Republikës së Shqipërisë pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe.
 - b. Taksës nbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.
 - c. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
 - ç. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
 - d. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.
- **Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:**
 - a. Pronat e shtetit dhe të njësisive vendore që përdoren për qëllime jofitimprurëse.
 - b. Pasuritë në pronësi të shtetit të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
 - c. Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrës me qira të paliberalizuara.
 - ç. Banesat sociale në pronësi të Bashkive.
 - d. Pasuritë e paluajtshme ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale.



- dh.** Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre.
- e.** Strukturat akomoduese “Hotel /Resort me katër dhe pesë yje, status special” sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe njëkohësisht “brand name”.
- ë.** Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë ose dhe me persona nëngarkim të tyre që janë të aftë për punë.
- f.** Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- g.** Ndërtesat kulturore nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

• Shkalla e Taksës

- a) 0.05 % për ndërtesat që përdoren, shfrytëzohen për banim.
- b) 0.2 % për ndërtesat që përdoren, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike.
- c) 30 % e shkallës së taksës përkatëse për gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë në afatin e përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

• Informacioni lidhur me taksën mbi ndërtesën

Këshilli i Ministrave përcakton rregulla në lidhje me :

- a) Natyrën dhe prioritetin e informacionit që do të përdoret në lidhje me përcaktimin e bazës së taksës mbi ndërtesat, në raste mospërputhjes të informacionit të marrë nga burime të ndryshme.
- b) Prioritetin e të dhënave që do të përdoren në lidhje me vlerën e tatueshme.

• Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë

- a) Menaxhon regjistrin që ndror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale).
- b) Udhëheq nga pikëpamja metodologjike në lidhje me administrimin e taksës mbi pasuritë e paluajtshme.
- c) Vlerëson vlerën e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat me metodat e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe detyrimin për taksën e pasurisë ndërtesë.

• Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore

- a) Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:
- b) Mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale.
- c) Përditësimin e të dhënave të regjistrit qëndror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme



(Kadastra Fiskale).

ç) Mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksave mbi ndërtesën.

d) Korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës në rastet e saktësisimit të informacionit për sipërfaqen, vendodhjen zonale, çmimet e tregut etj.

dh) Shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

• **Sipërfaqja e prezumuar**

Nëse identifikohet ekzistenca por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

a) 100% (njëqind përqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim.

b) 70% (shtatëdhjetë përqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar.

• **Vetëdeklarimi**

Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtesë/ njësi pronësore, që ka në pronësi apo në përdorim.

Vetëdeklarimi bëhet pranë njesisë së vetëqeverisjes vendore.

• **Burimet e informacionit**

a. Të dhënat e vetëdeklaruar nga taksapaguesi mbi ndërtesën/njesisë e ndërtesës në pronësi/përdorim të tij.

b. Të dhënat e disponuara nga ZVRPP-të lidhur me vlerësimin dhe rivlerësimin e ndërtesave, si dhe titujt e pasurisë mbi to.

c. Të dhënat e zyrave të urbanistikës për lejet e dhëna të ndërtimit.

ç. Të dhënat zyrtare të noterisë për transaksionet e shitblerjeve të ndërtesave.

d. Të dhënat e ALUIZNI-it për ndërtesat në proces legalizimi.

dh. Të dhënat e siguruar nga verifikimi në terren nga njësitet e vetëqeverisjes vendore.

e. Të dhënat nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile.

ë. Të dhënat nga subjekte ekonomike që kanë kontakte me konsumatorët, si psh : Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve apo dhe institucione të tjera të papërmendura më lart, të cilat disponojnë informacion mbi pasurinë ndërtesë/njësi ndërtesë, titujt pronësie apo statusin juridik të marrëdhënies së taksapaguesit në marrëdhënien e tij me pasurinë e paluajtshme objekt taksimi si dhe për vetë paguesin.

f. Të dhënat nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për pasuri të trajtuara me vendime KKKP-së.

Aneksi 1



Tabela 2 : Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, Bashkia Rrogozhinë është 41.000 lekë/m².

Nr	Kategoritë dhe nënkategori	Njësia	NjA Rrogozhinë		NjA të Tjera	
			Sipas ligjit	Propozimi	Sipas ligjit	Propozimi
	Ndërtesa Banimi		41000 lek/m ²		-35%	-35%
a	Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së banimit.(41000x1.5x0.2%=123lek/m ² Per Nj/A. Reduktohet -35%	Lekë/m ² /vit	123	123	80	80
a/1	Ndërtesa në vijën bregdetare Spille	Lekë/m ² /vit	123	123		
b	Çmimi për m ² sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrum është 70% e çmimit të sipërfaqes së banimit.(41000 x 70% x 0.2%)	Lekë/m ² /vit	57	57	37	37
c	Çmimi m ² sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30% e çmimit të sipërfaqes së banimit(41000 x 30% x 0.2%)	Lekë/m ² /vit	25	25	16	16
ç	Çmimi për m ² sipërfaqe ndërtimi të destinuar për veprimtari industriale si : prodhim, përpunim apo magazinim të mallrave industriale duke përfshirë fabrika,depo,e objekte të ngjashme është 50% e çmimit të sip.banesës (41000 x 50% x 0.2%)	Lekë/m ² /vit	41	41	27	27
d	Çmimi për m ² sipërfaqe ndërtimi që përdoret për bujqësi dhe blektori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim,magazinim e ruajtje të produkteve bujqësore e blegtorale është 30% e çmimit të sip. banesës	Lekë/m ² /vit	25	25	16	16
dh	Çmimi për m ² për ndërtesat që përdoren , shfrytëzohen për banim është 0.05% e					



	çmimit të referencës 41000 x 0.05%. (NJ/A – 35%)	Lekë/m ² /vit	20.5	20.5	13	13
e	Çmimi për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr.7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e ndërtesave shtetërore” i ndryshuar, çmimi për m ² është 70% (41000 x 70% x 0.05%)	Lekë/m ² /vit	14	14	10	10
ë	Çmimi për të gjithë sipërfaqen ndërtimore për të cilën zhvilluesi është i pajisur me leje ndërtimi por nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit është 30%. (41000 x 30% x 0.2%)	Lekë/m ² /vit	25	25	16	16

Aneksi 2

ÇMIMET MESATARE PËR METËR KATRORË SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR NDËRTE SAT QË NUK SHËRBEJNË PËR BANIM

- a. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe ndërtesat tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose edhe shërbime me pakicë.
- b. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 % (shtatëdhjetë) përqind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
- c. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim i hapur është 30 % (tridhjetë) përqind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
- ç. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrika, depo, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 % (pesëdhjetë) përqind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas qyteteve.
- d. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 % (tridhjetë) përqind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.
- dh. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë



qytetit përkatës, të cilat ju bashkuan njësisive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr.115/2014 reduktohet deri me 35 % (tridhjetë e pesë) përqind, krahasuar me çmimet e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

e. Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë. 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” i ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 % (shtatëdhjetë përqind) e çmimit sipas zonave të tabelës vetëm në rastin e shitjes së parë.

2.b -TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

➤ **Baza ligjore:** Ligji 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23 “Taksa mbi tokën bujqësore”, ANEKSI 1 , në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike; Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhinë si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

- Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.
- Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
- Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
- Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.
- Afati për shlyerjen e kësaj takse është brenda datës 30 Qershor të vitit kalendarik.
- Pagesat e taksës së tokës bujqësore do të kryhen dhe përlllogariten në masën 70 % të vlerës sipas kategorisë së tokës bujqësore kur paguhen brenda datës.30 Mars të vitit pasardhës.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike; Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë BashkisëRrogozhinë si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon :



Tabelë 3. Nivelet e taksës mbi tokën bujqësore

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Njësia e matjes	Niveli i taksës	Propozimi -30%
I	lekë/hektar/vit	5600	3920
II	lekë/hektar/vit	4900	3430
III	lekë/hektar/vit	4200	2940
IV	lekë/hektar/vit	3600	2520
V	lekë/hektar/vit	3000	2100
VI	lekë/hektar/vit	2400	1680
VII-X	lekë/hektar/vit	1800	1260

2.c- TAKSA MBI TRUALLIN

- **Baza ligjore:** Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23 /1, ANEKSI 2.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për qëllime biznesi është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhine si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

- a.** Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Kategoritë minimale të truallit jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.
- b.** Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
- c.** Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.
- ç.** Afati i pagesës së taksës së truallit për qëllime biznesi është data 20 Qershor e vitit kalendarik.



Tabelë 4. Nivelet e taksës mbi truallin

Lloji taksës	Vlera e taksës në lekë/m ² /vit	
	Për qëllime biznesi	Për Banim
A. Taksë trualli	12 lekë/m ²	0.14 lekë/m ²

3. TAKSA E FJETJES NË HOTEL

- **Baza ligjore:** Ligji nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, neni 26.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rogozhine si dhe zyrat e taksave pranë Njësi Administrative.

- a. Për qëllim të këtij ligji, me "Hotel" do të kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin njërin ose disa nga emërtimet: hotel, motel, stabiliment turistik, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
- b. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
- c. Niveli tregues i taksës është sipas aneksit 8 bashkëlidhur këtij ligji.
- d. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
- e. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
- ë. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë në juridiksionin e së cilës ndodhet vendodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Tabelë 5. Nivelet e taksës së fjetjes në hotel

Emërtimi	Nivelet e taksës
a. Hotelet 4-5 yje	105 lekë/natë/ fjetje/person
b. Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	35 lekë/natë /fjetje/person



4.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË

- **Baza ligjore:** Ligji nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, neni 27. Ligji 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, Ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Udhëzimit nr.3, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave" për vitin 2016.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së Ndikimit në Infrastruktura është Drejtoria e Politikave Urbane dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhinë.

- Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.
 - Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 % (katër përqind) deri në 8 % (tetë përqind) të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare e cila banesat ekzistuese. Gjithashtu në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.
- Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësisve të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerrë me akt nga Këshilli i Ministrave.
- **Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është :**

- a. Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët të ndërtuara vetë individi apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 - 3 % (një deri në tre përqind) e vlerës së investimit.
- b. Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0.1 % (zero pikë një përqind) e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
- c. Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 % (zero pikë pesë përqind) e vlerës së investimit.
- d. Për ndërtesat që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0 - 3 % (zero deri në tre përqind) të vlerës së investimit. Këshilli Bashkiak përcakton me vendim zonat malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi.
- dh. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet për llogari të bashkisë që mbulon territorin ku do bëhet investimi.
- e. Nëse objekti për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të



ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

ë. Nëse objekti për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

• Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse :

a. Investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special” sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”.

b. Investimet e subjekteve të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

c. Investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtim nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

ç. Investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

Sipas Relacionit të mësipërm tarifat për vitin 2023 të zyrës së Drejtorisë së Politikave Urbane për shërbime të ndryshme ndaj qytetarëve janë :

a. Taksë Aplikimi (Hapje Dosje).....1.000 lekë.

b. Tarifa për punimet që kryhen me deklaratë paraprake punimesh të jetë 2% i vlerës së preventivit.

c. Tarifa për punimet që kryhen pa deklarate paraprake punimesh të jetë 4.000 lekë.

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i Taksës ne përqindje %
<p>a. Ne rastin e ndertimeve te destinuara per qellime banimi apo per njesi tregtimi dhe sherbimi, te cilat kryhen nga shoqeri ndertimi, shkalla e taksës se ndikimit ne infrastrukture eshte ne masen 4(kater)% (perqind) deri ne 8(tete) % (perqind) te cmimit te shtijes per m². Ne kete kategori investimesh perfshihen edhe ndertimet zevendesuese per qellime banimi, te kushtezuara per tu ndertuar si shkak i zbatimit te nje kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Ne kete kategori pefshihen edhe ndertimet e destinuara per qendra tregtare apo biznesi. Baza e taksës eshte vlere ne leke per m² e cmimit te shitjes se ndertimeve per qellime banimi apo te njesive te tregtimit apo sherbimit. Cmimi i shtijes per m² bazohet ne vleren referuese te tregut, sipas percaktimeve te nxjerre me akt nga Keshilli i Ministrave.</p>	<p>4 (katër) % (përqind)</p>
<p>b. Per ndertimet qe destinohen per perdorim ne sektorin e turizmit, te industrise, bujqesise, te ndertimeve individuale per qellime te perdorimit vetjak nga individet, te ndertuara vete individi apo sipermarres; si dhe te ndertimeve per</p>	<p>3 (tre) % (përqind)</p>



qellime publike	
c. Per ndertimet individuale per qellime te perdorimit vetjak nga individet,te ndertuara nga vete individet apo me sipermarres	2(dy) % (përqind)
d. Per projekte te infrastruktures,per ndertimin e rrugeve kombetare,te porteve,aireporteve,tuneleve,digave,ndertimit te infr. ne energji,perfshire makinerite dhe paisjet	0.1(zero pike nje) %(perqind) e vleres se investimit,por jo me pak se kostoja e rehabilitimit te infrastruktures se demtuar,kur kjo kosto nuk eshte e perfshire ne preventivin e investimit
e. Per ndertesat,te cilat jane ne proces legalizimi	0.5(zero pike pese) %(perqind) e vleres se investimit

SHËNIM: Nëse Vlëra mer m^2 e preventimit të projektit të objektit të paraqitur nga investitori pranë DPU-së , është më e madhe se vlëra 32105 leke/ m^2 e llogaritur nga EKB-ve, atëherë për llogaritjen e tarifës që do paguhet pranë Bashkisë Rrogozhinë do të merret për bazë ajo e preventivit të sjellë nga vete investitori.

Tarifat për Akt-Kontrollet në faza të ndryshme të ndërtimit të objekteve të ushtruara nga personeli i Zyrës së Drejtorisë së Politikave Urbane.

Në bazë të VKM-së nr. 408 datë 13.05.2015 të Rregullores së Zhvillimit të territorit , neni 27/1 për mbikqyrjen e punimeve, mbahen Akte Kontrolli kundrejt pagesave të mëposhtme:

A	Ngritje kantieri + Muri rrethues	Për Banesë Për Biznes Për Pallatet+Bregdet	10 lekë/ m^2 (Të sip.totale të ndërtimit) 20 lekë/ m^2 -/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/ 25 lekë/ m^2 -/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/
B	Piketim Objekti	Për Banesë Për Biznes Për Pallatet+Bregdet	10 lekë/ m^2 (Të sip.totale të ndërtimit) 20 lekë/ m^2 -/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/ 25 lekë/ m^2 -/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/
C	Përfundimi i Themeleve kuota 0.00	Për Banesë Për Biznes Për Pallatet+Bregdet	10 lekë/ m^2 (Të sip.totale të ndërtimit) 15 lekë/ m^2 -/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/ 25 lekë/ m^2 -/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/
Ç	Përfundimi i karabinasë	Për Banesë Për Biznes Për Pallatet+Bregdet	10 lekë/ m^2 (Të sip.totale të ndërtimit) 15 lekë/ m^2 -/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/ 25 lekë/ m^2 -/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/-/



D	Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave+ sistemet e ndryshme si ngrohje, ftohje, elekt etj	Për Banesë	5 lekë/m ² (Të sip. totale të ndërtimit)
		Për Biznes	15 lekë/m ² -/-
		Për Pallatet+Bregdet	25 lekë/m ² -/-
DH	Përfundimi i sistemimeve të jashtëme	Për Banesë	5 lekë/m ² (Të sip. totale të ndërtimit)
		Për Biznes	15 lekë/m ² -/-
		Për Pallatet+Bregdet	25 lekë/m ² -/-

Në total, të gjitha Akt-Kontrolli bëhen këto pagesa :

1-Për banesë	50 lekë/m ² (Të sip. totale ndërtimi)
2-Për Biznes	100 lekë/m ² (Të sip. totale ndërtimi)
3-Për Pallatet dhe Bregdet	150 lekë/m ² (Të sip. totale ndërtimi)

SHËNIM: Për Objektet që janë pajisur me Leje Zhvillimi dhe Leje Ndërtimi para këtij vendimi, tarifa e Akt-Kontrolleve do të paguhet me vlerat e mëparshme.

• Tarifat për marrjen e Çertifikatës së Përdorimit të Objekteve

1-Çertifikatë Përdorimi për Banesë	100 lekë/m ² (Të sip. totale ndërtimi)
2-Çertifikatë Përdorimi për Biznes	150 lekë/m ² (Të sip. totale ndërtimi)
3-Çertifikatë Përdorimi për Pallatet	250 lekë/m ² (Të sip. totale ndërtimi)
4-Çertifikatë Përdorimi për Zonën Turistike	250 lekë/m ² (Të sip. totale ndërtimi)

5.TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

➤ Baza ligjore: Ligji 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 28, 29.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në rolin e agjentit tatimor, të cilat përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit të bashkisë Rrogozhinë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

- Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit,



pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave për efekt për efekt të bazës së taksueshme jepen në tabelën nr.6. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 % (dy përqind). Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

• Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat në rolin e agjentit të taksave përfitojnë 3 % (tre përqind) të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

• **Përfshihen nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë të paluajtshme:**

a. Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore.

b. Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshimet përkatëse;

c. subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme, kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

• institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

• bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përjashtimin nga taksa bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

ç. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje për shmangie nga taksa, zbatohet taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

Tabela 6 . Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi ndërtesat.

	Emërtimi	Njësia	Shkalla tatimore	
			Nj.A Rrogozhinë	Nj.A të tjera
A	Ndërtesa Banimi	lekë/m ²	100	100
B	Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime	lekë/m ²	300	300
C	Ndërtesa të tjera	lekë/m ²	200	200

6. TAKSA E TABELËS

Baza ligjore: Ligji 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 32.



Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së Tabelës është zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhinë si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

• Taksa arkëtohet së bashku me taksat e tjera vendore jo më vonë se data 30 Qershor e vitit kalendarik.

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet të cilët vendosin tabela të lëvizshme apo të palëvizshme për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë osë brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare osë në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë qofshin këto publike ose private.

2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, tabelat kategorizohen në:

i) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logo dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabele identifikuese vetëm njëra do konsiderohet e tillë.

ii) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendodhjes së veprimtarisë së subjektit.

iii) Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme apo e palëvizshme e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si në tarraca, llozhe, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj... që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

iv) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapur, panairë, spektakle, stenda etj.

3. Taksa e tabelës është vjetore, bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklame për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës, shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj.

5. Nivelet e taksës tabelës sipas kategorizimeve përcaktuara në tabelën 7, si më poshtë vijon

Tabela 7 . Taksa e tabelës sipas kategorive të Bashkive.



Nr	Llojet e Tab	Nj/matës	Bashkia Kat.1	Bashkia Kat.2	Bashkia Kat.3
I	Taksë tabelle për qëllime indentifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe ose aktiviteti i biznesit)				
a	Deri në 2 m²	Lekë /m ² /vit	<u>0</u>	<u>0</u>	0
b	-mbi 2 m² deri 10 m²				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	15.000	10.000	7.000
	-me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	20.000	15.000	11.500
	-elektronike	Lekë/m ² /vit	35.000	20.000	15.000
c	mbi 10m² deri 20m²				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	12.750	8.500	5.950
	-me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	17.000	12.750	9.775
	-elektronike	Lekë/m ² /vit	29.750	17.000	12.750
d	mbi 20m² deri 40m²				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	8.250	5.500	3.850
	-me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	11.000	8.250	6.325
	-elektronike	Lekë/m ² /vit	19.250	11.000	8.250
e	mbi 40m²				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	6.000	4.000	2.800
	-me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	8.000	6.000	4.600
	-elektronike	Lekë/m ² /vit	14.000	8.000	6.000
II	Tabela për qëllime indentifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim				
	-Tabela identifikuese	Lekë/m ² /vit	120	120	120
III	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri ne tavanin maksimal 35m²		Bashkia Tirane	Bashkia Durres dhe gjith bashkite e tjera ne Kat.II	Bashkite e Kat.III
	-e thjeshte(me pa ndricim)	Lekë/m ² /vit	45.000	22.500	13.500
	-elektronike	Lekë/m ² /vit	90.000	45.000	27.000
IV	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura,panaire,spektakle,stenda reklamuese,banderola,etj				
	-të të gjitha llojeve dhe përmasave	Lekë/m ² /vit	1.000	1.000	1.000



Shënim : Bashkitë sipas kategorive ndahen:

Kategoria I : Tiranë, Durrës.

Kategoria II : Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë, Berat, Korçë, Pogradec, Sarandë, Lushnjë, Gjirokastër, Lezhë, Krujë.

Kategoria III: Të gjithë Bashkitë e tjera duke përfshirë edhe *Bashkinë Rrogozhinë*.

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10m², shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri në 10 m² do t'i shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.sh, një tabelë të thjeshtë 15m², shuma e taksës vjetore do të llogaritet : (10m² x 15.000Lekë) + (5m² x 12.750Lekë) = 150.000+63750 = 213.750 lekë në vit (ose 17.812 lekë/muaj). E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m² dhe mbi 40 m². Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë. Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35m² do të konsiderohet sikur është 35m² dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m². Në kategorinë e reklamës kuptojmë çdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, të vendosur në pamje jo ballore, në tarraca, lozhe, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla, etj që kanë me qëllime reklamimi për vete ose të tretë.

7. TAKSA E MJETEVE TË PËRDORURA

- **Baza ligjore:** Ligji Nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, neni 3 pika 3, neni 4, pika 3, neni 8 pika 2 shkronja c.
- **Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale në rolin e agentit tatimor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Arkëtojnë 25% të taksës pas marrjes së komisionit të tyre prej 5%.**
- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës :
Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit.
- Taksa fikse për llojin e karburantit është 12.5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën.
- Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse.
- Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit.



8. TË ARDHURA PJESORE NGA TAKSA E RENTËS MINERARE

Baza ligjore: Ligji Nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, neni 3 pika 4, neni 4 pika 4, neni 8 pika 2 shkronja “d”.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse është Dega e Doganave në rrethe, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

- Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare 5% (pesë përqind) e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.
- Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.
- Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës kur janë realizuar shitjet.

9.TARIFË PËR INFRASTRUKTURËN NËNTOKËSORE (TELEFON,INTERNET,KABLLOR)

➤ **Baza ligjore:** Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2016 “ Për sistemimin e Taksave Vendore” , të ndryshuar, neni 34 pika 2. Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9, pika 1.3 b); Ligji 68/2017 datë 24.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 13.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhine si dhe Zyrat e Taksave pranë Njësive Administrative.

- Për rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse apo të shërbimit informatik, tarifat vendore vendosen vetëm në rastin kur subjektet përdorin rrjetet infrastrukturore, si: tubacione, kanale, linja ajrore etj., të cilat janë ndërtuar dhe janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Të ardhurat e siguruara prej tyre shërbejnë për përballimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit në përdorim.
- Baza e tarifës për linjat ajrore dhe nëntokësore është gjatësia lineare për kilometër e linjave ajrore dhe nëntokësore e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi.



Nivelet e Tarifës së përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore:

a. Linja ajrore, telefon, tv kabllor, internet	Lek/km/vit	1.500 lekë
b. Linja nëntokësore telefon, tv kabllor, internet	Lek/km/vit	3.000 lekë

Kapitulli II TARIFAT VENDORE

II.1 TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE SI DHE TARIFA E SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR BIZNESIN

a-Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë subjektet taksapagues, persona juridikë ose fizikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Rrogozhine dhe njësisive të saj administrative.

b- Tarifa për shërbime publike është detyrim i çdo subjekti taksapagues i cili përfiton shërbime të tilla si ndriçim, gjelbërim, mirëmbajtje të rrugëve, etj., përveç pastrimit.

c- Nipti për fermerë nuk ka asnjë përgjegjësi tatimore e për rrjedhojë asnjë detyrim për të paguar.

• Në rastin kur subjekti krijohet (regjistrohet) apo mbyllet gjatë vitit kalendarik, detyrimi për tarifën e pastrimit dhe shërbimeve llogaritet dhe arkëtohet proporcionalisht me kohën aktive të ushtrimit të aktivitetit jo më pak se 1 (një) muaj me përjashtim të zonës Turistike e cila e ka detyrimin vjetor. Afati i pagesës së këtyre detyrimeve është data 30 Qershor e vitit aktual kalendarik dhe pas kësaj date për çdo ditë vonesë aplikohet kamatvonesë në masën 0.06% për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë.

• Nivelet e tarifës së pastrimit dhe tarifës së shërbimeve për kategoritë dhe nënkategoritë biznesi i vogël dhe i madh, person juridik apo fizik si dhe institucione janë të paraqitura në tabelat si më poshtë:

Tabela 8 . Tarifat e Pastrim, Gjelbërim dhe Ndricim për Biznesin e Vogël 2023

Emërtimi	Lekë /vit/sez	Tarifë Pastrimi	Tarifë Gjelbërimi	Tarifë Ndricimi
1- Shitje me Pakicë				
a) Bar Kafe, byrek, etj.		10.000	1.000	1.000
b) Bar Bufë Restorant, fast food etj, të ngjashme me to		15.000	1.000	1.000



c) Restorante (Dasma,etj)		30.000	1.000	1.000
d) Ushqimore, minimarket, fruta perime, veshmbathje, bulmet, mish, peshk, fastfood, Beach Bar, Butik, etj.		15.000	1.000	1.000
e) Tregtim pjesë këmbimi e servis mekanik.		20.000	1.000	1.000
f) Tregtim materiale ndërtimi si tulla, tjegulla dërrasa, çimento, gëlqere, blloqe betoni etj.		20.000	1.000	1.000
g) Tregtim lëndë djegëse si dru, qymyr, pelet etj		15.000	1.000	1.000
h) Tregtim plehra kimike, pesticide fara e fidanë		20.000	1.000	1.000
i) Tregtim pajisje industriale e afrim shërbimesh për artikuj të ndryshëm		20.000	1.000	1.000
2. Prodhime si më poshtë: Miell për Bukë e Blegt.		15.000	1.000	1.000
* Prodhime material druri e duralumini		30.000	1.000	1.000
a) Prodhim e shitje buke e n/produnkte të tij		15.000	1.000	1.000
b) Grumbullim përpunim qumështi e n/prod		20.000	1.000	1.000
c) Prodhim vaj ulliri	Sez	15.000	1.000	1.000
3. Profesione të lira				
a) Farmaci të të gjitha llojeve	Vit	20.000	1.000	1.000
b) Klinika dentare, laboratore, qendër mjekësore		20.000	1.000	1.000
c) Këpucar, berber, fotograf, rrobaqepës etj		10.000	1.000	1.000
ç) Ndërtues, murator etj.		20.000	1.000	1.000
d) Hotele, motele, shtëpia që shërbejnë për akomodimin e turistëve, etj të ngjashme (vija bregdetare)	Sez	50.000 + 100 lekë për dhomë	2.500	2.500
dh) Hotele, motele etj të ngjashme në zonat e tjera		30.000	1.000	1.000
e) Tregtim pjesë e mjeteve të përdorura		30.000	1.000	1.000
ë) Tregtim mjete të reja		30.000	1.000	1.000
f) Lodra uji		20.000	1.000	1.000
g) Autoskollë e Agjensi udhëtimi, Internet,telefon		20.000	1.000	1.000
h) Peshkimi në ujëra të ëmbla e të kripura		20.000	1.000	1.000
j) Kalceto(fusha sportive për të rritur e femijë)		15.000	1.000	1.000
k) Shitje online		10.000	1.000	1.000

Tabela . 9 Tarifat e Pastrim, Gjellbërim dhe Ndriçim për Biznesin e Madh viti 2023

Emërtimi	Lekë/ vit	Tarifë Pastrimi	Tarifë Gjellbërimi	Tarifë Ndriçimi
Tarifat e Biznesit Madh				
1-Shitje me pakicë e shumicë				
a) Ushqimore Supermarketi		50.000	2.500	5.000
b) Njësi tregtimi vetëm me shumicë		50.000	2.500	5.000
c) Import-Eksport pjesë këmbimi auto, motorrike		60.000	2.500	5.000
ç)Tregtim materiale ndërtimi		50.000	2.500	5.000



d) Tregtim lëndë djegëse karburante rrug. nac		50.000	5.000	5.000
dh) Tregtim karburante jo rrugë nacionale		50.000	5.000	5.000
e) Shitje automjetesh, mobileri etj.		50.000	2.500	5.000
ë) Tregtim plehra kimik, inpute bujqësore etj.		40.000	2.500	5.000
f) Tregtim pajisje industriale prodhuese e makineri		60.000	2.500	5.000
2-Prodhome				
a) Prodhome buke apo nënprodukte mielli		50.000	2.500	5.000
b) prodhim përpunim qumështi		50.000	2.500	5.000
c) Prodhim përpunim mishi e nënprodukte të tij		50.000	2.500	5.000
ç) Prodhim materiale ndërtimi e inerte		60.000	2.500	5.000
d) Prodhim konfeksione e veshmbathje etj		50.000	2.500	5.000
dh) Prodhim materiale plastike		50.000	2.500	5.000
e) Prodhim dyshek, jorgane etj		50.000	2.500	5.000
ë) Prodhim të produkteve të drurit e të duraluminit etj		50.000	2.500	5.000
3-Shërbimet				
a) Banka private apo filiale të tyre, të ngjashme me to		50.000	2.500	5.000
b) Kompani, Agjensi sigurimesh, Këmbim valutor, transport etj		50.000	2.500	5.000
c) Media televizive, Kabllor, etj të ngjashëm me to.		50.000	2.500	5.000
ç) Shërbime postare, kompani telekomunacioni, shërbime interneti, telefoni fikse etj të ngjashëm me to.		50.000	2.500	5.000
d) Për çdo autoshtet, polici private, kurse kualifikimi etj		50.000	2.500	5.000
dh) Për çdo njësi edukimi si shkolla, kopshti, klub sportiv, etj		40.000	2.500	5.000
e) Ndërmarrje shërbim Energjie Elektrike, Ujësjellës Kanalizime, etj		60.000	2.500	5.000
ë) Lojra fati, loto sport, baste sportive, etj		40.000	2.500	5.000
4. Biznesi me aktivitet Ndërtimi				
a) Për çdo kantier ndërtimi të ngritur në raport me kohëzgjatje deri në përfundim ndërtimi.		60.000	2.500	5.000
5) Për çdo axhensi transporti me Nipt parësor apo sekondar sipas Q.K.B		50.000	2.500	5000
a) Transport Udhëtarësh deri në 8+1		5.000	1.000	1.000
b) Mbi 8+1		15.000	1.000	1.000
c) Transport mallrash deri në 3.5 ton		5.000	1.000	1.000
ç) Mbi 3.5 ton		15.000	1.000	1.000
k) Për çdo motobarkë peshkimi		10.000	1.000	1.000
l) Për çdo barkë me motor apo pedalone në shërbim të pushuesve në stacione plazhi zona Spille		5.000	-	-
6) Institucione si :				
N) Qendër Shëndetësore, Reparte ushtarake, Rajone Policie, Qendër Riedukimi (Burgje), etj të ngjashme		50.000	2.500	5.000
NJ) Subjektet që përfitojnë tendera shërbimesh e punimesh brenda territorit të bashkisë		100.000	10.000	10.000



II.2 TARIFË E ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE PËR ZONËN E PLAZHIT

➤ **Baza ligjore:** Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2016 “ Për sistemimin e Taksave Vendore” , i ndryshuar, Ligji nr.93, viti 2015 “Për turizmin” i ndryshuar.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së hapësirës publike “Stacion Plazhi” është zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhinë.

- Baza e taksës për zënie të hapësirës publike për zonën e plazhit është sipërfaqja në m² e vijës bregdetare, e cila shfrytëzohet nga individë apo subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim sezonal i taksapaguesit.
- Për shfrytëzimin e vijës bregdetare si stacione Plazhi,

Për kontratat ekzistuese afati i pagesës është momenti i rinovimit të kontratës.

Për lidhjen e kontratave të reja pagesa e tarifës duhet të kryhet në të njejtën kohë me nënshkrimin e kontratës nga Bashkia.

Tabela 10. Niveli i tarifës së zënies së hapësirës publike për zonën e plazhit Spille.

Zona	Niveli i taksës
1) Vija bregdetare .	
a) Vendosje shezllone e çadra sipas kontratës së nënshkruar nga Bashkia.	200 lekë/m²/në sezon.
b. Çmimi i sipërfaqes së ndertesës sipas plan vendosjes	200 lekë/m² në vit
c. Çmimi i sipërfaqes rërë për vendosje lodra e lojëra për fëmije	200 lekë/m² në sezon
d. Vendosje tavolina në sipërfaqen pyll në pisha	100 lekë/m² në sezon
2) Tarifat për ngritjen e kampingjeve e objekteve të lëvizëshme.	
a. Vendosje çadra pushimi deri në 4 vende	100 lekë/ditë/copë
b. Vendosje çadra pushimi mbi 4 vende	200 lekë /ditë/copë
c. Vendosje Rulota (Jo më pak se 25.000 lekë/sezon)	300 lekë/ditë/copë
d. Vendosje Baraka portative (Jo më pak se 25.000 lekë/sezon)	300 lekë/ditë/copë
e. Shitës ambulante (Spille) (Jo me pak se 15.000 lekë/sezon)	100 lekë/ditë/m²
f. Parkim automjetesh (Spille)	100 lekë/ditë/automjet



Shënim: Për vendosjen e tavolinave për shërbime ndaj pushuesve dhe ngritjen e kampingjeve sipas pikës a,b,c,d do të merret leje nga Bashkia. Për vjeljen e tarifës ngarkohet Nj/A. Kryevidh.

•Për vijën bregdetare në zonën e Vilë Bashtovës të Njesisë Administrative Gosë niveli i taksës do të jetë 50% e tarifës së Spillesë.

II.3 TARIFË “TREGU I LIRË”

- Kjo tarifë aplikohet në zonat e konsideruara Markatë.Tarifa është detyrim ditor i çdo individi që tregon mallra për konsumatorët finalë. Individët përkundrejt tarifës pajisen me biletë nga agjenti mbledhës.
- Niveli i aplikuar i tarifës për Tregun e Lirë është 50 lekë/m².

Shënim : Për tregjet e lira që do të zhvillohen në hapësira private do të lidhet kontratë me Bashkinë Rrogozhinë ku do të përcaktohet sipërfaqe,vlera ,mënyra e pagesës dhe afati i kontratës. Po kështu edhe për tregjet e lira “ hapësira publike” pronë e bashkisë do të lidhet kontratë me Bashkinë me të njëjtat kriteret të tregjeve private.

• Për vjeljen e tarifës “Tregu i lirë“ ngarkohet Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhinë dhe zyrat e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Nj/ Administrative përkatëse.

Tabela 11. Tarifat e Liçensimit të Transportit të udhëtarëve e të mallrave

Nr	Kategoritë	Njësia matjes	Tarifa e liçensimit të transportit
1	Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/5 vjet	40.000
2	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/mjet/vit	1.000
3	Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Lekë/5 vjet	20.000
4	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Leke/mjet/vit	1.500
5	Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda	Lekë/5vjet	75.000
6	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda	Lekë/mjet/vit	1.500
7	Licensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet	Lekë/5/vjet	75.000



8	Çertifikatë për transport udhëtaresh në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet	Lekë/mjet/vit	1.500
9	Licensë për agjensi transporti udhëtaresh dhe taksi brenda	Lekë/5 vjet	15.000
10	Licensë për agjensi ndërkombëtare udhëtaresh	Lekë/5 vjet	40.000
11	Licensë për transport udhëtaresh me taksi	Lekë/mjet/5vjet	20.000
12	Dhënie autorizim për transport ndërqytetas	Lekë/mjet	2.000
13	Licensë për shërbim të rregullt të specializuar të transportit të udhëtareve	Lekë/5 vjet	20.000
14	Çertifikatë për transport udhëtaresh për llogari të vet	Lekë/mjet/vit	1.500
B	Tarifa Licensimit të Transportit të Mallrave		
1	Licensë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit	Lekë/5 vjet	40.000
2	Çertifikatë për transport mallrash për të tretë e për vete brenda vendit	Lekë/Ton/vit	100
3	Çertifikatë për transport mallrash dhe udhetarë	lekë	3.000

II.4 TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE

➤ **Baza Ligjore :** Ligji Nr.9632, datë.30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së parkimit të automjeteve është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Rrogozhinë dhe zyrat e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Nj/ Administrative përkatëse.

- Tarifa e parkimit të automjeteve është detyrim i çdo individi i cili parkon në vendet e miratuara si “Parkim publik me Pagesë”.
- Tarifa është 100/lekë/automjet /ditë dhe arkëtohet në momentin e parkimit.
- Kjo tarifë do të paguhet edhe për vijen bregdetare Spille për të cilën ngarkohet Nj.A Kryevidh.

Tabela 12. Parkime të Rezervuara me Leje nga Bashkia për qytetin Rrogozhinë:

a) Autoveturë 4+1 dhe 8+1	Niveli taksës 15.000lekë/vit
b) Automjet Transporti të përzier nga 0-3.5ton	Niveli taksës 15.000lekë/vit



Shënim. Subjektet e biznesit të vogël mund të marrin leje vetëm për 1-2 vende parkimi, ndërsa subjektet e biznesit të madh jo më shumë se 2-4 vende parkim. Leja nuk mund të jepet për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit.

II.5 TARIFA PËR VULOSJE VETERINARE BAGËTIVE TË THERURA NË VENDE TË LEJUARA

Baza Ligjore : Ligji Nr.10465 datë 29.9.2011 “Për shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”. Akti Normativ Nr.4 datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre” dhe Vendimin Nr.230 datë 20.03.2013 Për përcaktimin e funksioneve të veta.

Emërtimi	Njësia	Niveli i tarifës
a - Për bagëti të trasha	Lekë/kokë të therur	200
b - Për bagëti të imëta	Lekë/kokë të therur	100
c - Për derra	Lekë/kokë të therur	50
d - Për shpendë	Lekë/kokë të therur	10

II.6 TARIFA BAZË TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË PËR LLOJET INDUSTRIALE

Baza Ligjore: VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim, përdorim të fondit Pyjor Kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhim drusor dhe jo drusor”.

Emërtimi	Njësia	Tarifa
1. Pishë Mesdhetare	m ³	Deri 22 cm 2300 lekë
	m ³	Mbi 22 cm 3200 lekë
2. Dru zjarri		
a) Të forta: Dushk, Ah, Panj etj të ngjashme	m	500
b) Të buta: Halore, shëlg etj të ngjashme	m	200

Shënim: Kur lënda e punimit apo drutë e zjarrit janë nxjerrë nga sipërfaqe të djegur por materiali drusor është i përdorshëm, tarifa për to do të jetë 40% më e ulët se tarifa bazë.

Tarifat për dhënie në përdorim të fondit pyjor për mbarështrimin e faunës së egër dhe gjahut

Nr	Përdorimi territorit	Tarifat sipas kohëzgjatjes lekë/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll trungishte	36000	34000	30000
2	Pyll cungishte	24000	23000	20000
3	Pyll shkurre	24000	23000	20000
4	Kullota	24000	23000	20000
5	Tokë me bimësi pyjore	18000	17000	15000
6	Inproduktive	18000	17000	15000



Tarifat për dhënie në përdorim të fondit pyjor për qëllime argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe vëprimtari turistike kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive shlodhëse

Nr	Përdorimi territorit	Tarifat sipas kohëzgjatjes lekë/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll trungishte	180000	120750	100000
2	Pyll cungishte	126000	9000	75000
3	Pyll shkurre	126000	9000	75000
4	Kullota	126000	9000	75000

Tarifat për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta.

Emërtimi	Njësia matjes	Tarifa / lekë
a) Gjethë të ndryshme	Kv	150
b) Rrënjë të ndryshme	Kv	250
c) Herba të ndryshme	Kv	70
d) Boçe të ndryshme	Kv	200
e) Degë të gjelbëra me dhe pa lule	Kv	100

Niveli i tarifës për Ujitjen në tokat bujqësore

Kategori, nënkategori	Njësia	Niveli i tarifës
a) Me rrjedhje të lirë	Lekë/ha/ rast ujitje	3000
b) Me rrjedhje mekanike	Lekë/ha/rast ujitje	2000

- **Baza ligjore : Ligji 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9.**

Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Bujqësisë, Zyra e Taksave e Tarifave Vendore dhe Njësitë administrative për llogaritjen e kësaj tarife.

Niveli i Tarifës për Kultivimin e peshkut në rezervuaret e ujit për vaditje

- Për të gjithë Ujë mbledhësit (Rezervuaret) të cilët do të shfrytëzohen për aktivitet akuakulturë (rritje ,kultivim, mbarështim rasati e peshku) tarifa vjetore do të jetë 15.000 lekë
- Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra e Taksave e Tarifave vendore dhe Njësitë administrative për llogaritjen dhe arkëtimin e kësaj tarife.

•Kategori, nënkategori e tarifës për zënie hapësire publike përveç zonës bregdetare

	Njësia	Niveli i tarifës	
		Sezon Veror	Sezon Dimëror
A- Njësia Administrative Rrogozhine 1-Vendosje	Lekë/m ² /muaj	60	60



tavolinash jashtë objektit të aktivitetit : a- Zona A .Brenda Qendrës së Qytetit (Zonë pedonale)			
b- Zona B .Jashtë Qendrës së Qytetit (Periferi)	Lekë/m ² /muaj	60	60
2-Mallra të vendosura jashtë objektit të aktivitetit, rrethime me vazo, lulishte etj.	Lekë/m ² /muaj	60	
c-Aktivitetet në qendër të qytetit, veprimtari promocionale, të ndryshme etj.	Lekë/m ² /ditë	1000	1000
B- Njësitë Administrative të tjera 1-Vendosje tavolinash jashtë objektit të aktivitetit .	Lekë/m ² /muaj	60	60
a-Mallra të vendosura jashtë objektit të aktivitetit, rrethime me vazo, lulishte etj.	Lekë/m ² /muaj	60	60
3-Aktivitetet në Qendren kulturore (Kinema) qendër të qytetit, veprimtari promocionale, takime,aktivitete sociale,kulturore,politike etj.të ngjashme	Lekë/orë	2500	2500
4-Vendosje kënd lojërash për fëmijë në qendër të qytetit.	Lekë/m ² /muaj	60	60
5-Aktivitete në pika turistike Kalaja Bashtovë etj të ngjashme	Lekë/orë	3 000	3 000
6-Ambulant e Rulot : Perveç zonës bregdetare Spille		15 000	15 000

Nivelet e tarifës për dhënie license për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj

- **Baza Ligjore :** VKM Nr.970 datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika II.

Struktura e ngarkuar për dhënien e licensave dhe arkëtimin e tarifës për dhënien e tyre është Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Dhënia e licensave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga Bashkia Rrogozhine, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territor të saj.



Tarifë për dhënie licenca për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj

	Njësia	Niveli i tarifës
a- Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikantë për 5 vjet.	Lekë/liçencë	1 000 000
b- Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregimit për përdorim nga konsumatorët fundorë për 5 vjet.	Lekë/liçencë	100 000

Nivelet e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "Familje"

Detyra kryesore e Bashkisë Rrogozhine është të sigurojë shërbime publike sa më cilësore, me efektivitet sa më të lartë dhe në kohë sa më të shpejtë ndaj të gjithë qytetarëve të saj për vitin 2023. Llojet e taksave dhe tarifave vendore që do të aplikohen për familjet si dhe nivelet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

III 1-Sipas Njesisë Administrative	Nr familjeve	Lloji i tarifës	
		Tarifë Pastrimi Lekë/Vit	Tarifë Shërbimi (Gje+Nd+V)
1-Nj.A.Rrogozhinë	2966	1200	800
2-Nj.A.Gosë Zona A. G.QendërG.Vogël, Kërcukaj, Vilë, Ballaj. Zona B. Kalush, Gosë e Madhe	1860 510	1200 600	800 800
3-Nj.A.Lekaj Zona A. Lekaj, Luz,Shkozet, Harizaj,Kryeluzaj,Gërmenj.	1820	1200	800



Zona B.Zanbishë,Okshtun.	430	600	300
Zona C.Mushnikë, Mlik.	70	0	300
4-Nj.A. Kryevidh.			
Zona A.Kryevidh, Greth i Mesëm, Spille, Ballaj, Zhabjak.	1056	1200	800
Zona B. Sharrdushk , Greth M	224	600	800
Zona C. Kazie, Domen, Spanesh, Patk Milot, Stërbeg.	656	0	300
5-Nj.A.Sinaballaj			
Zona B. Sinaballaj.	527	600	800
Zona C. Fshatra të tjerë	0	0	300

1 Gjoha për mosshlyerje në afat të detyrimit

Gjobat aplikohen vetëm për subjektet e tatueshme (që kanë detyrim pajisjen me NIPT). Afati i fundit për likuidimin e detyrimit vjetor të vitit aktual është data 30 qershor e po këtij viti. Baza e llogaritjes së gjobës për mosshlyerje përfshin detyrimet totale të gjithë vitit aktual që lindin nga tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, tarifa e shërbimeve, taksa e tabelës për qëllime identifikimi, taksa e ndërtesës ,taksa e truallit, etj., sipas faturës për pagesë.

Subjektet e reja si dhe adresat sekondare të çelura rishtazi kanë afat deri në 30 Qershor për shlyerjen e detyrimit. Nëse çelja bëhet pas datës 30 Qershor, afati i fundit për shlyerjen e detyrimeve tatimore është 30 ditë pas datës së rregjistrimit.

Niveli i gjobave për mos shlyerje të detyrimeve tatimore (taksa, tarifa)

III.1- a) Kategoritë	Njësia	Niveli i gjobës
1- Gjoha për mosshlyerje të detyrimeve tatimore (taksa, tarifa) per biznesin pas dt.30 Qershor te vitit ushtrimor (kalendarik).	% / ditë vonesë (jo më shumë se 365 ditë kalendarike)	0.06% në ditë

> **Baza ligjore** : Ligji Nr.9920 , datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, KREU XIV, Neni 114 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, pika 1.



Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe mbledhjen e këtyre gjobave është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative. Zbatimi i gjobave të paraqitura në tabelën më poshtë, u ngarkohet të gjitha drejtorive përkatëse në bashkëpunim me Sektorin e Policisë Bashkiake.

Përjashtohen nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara me ligj të veçantë.

Nr	III.2- a) Lloji i kundërvajtjes së kryer	Masa e gjobës	Vlera e ç'dëmtimit për kundërvajtjen e kryer
1	Për dëmtim, çarje dhe ndotje rruge	10 000 lekë	4 000 lekë/ m ² rrugë e dëmtuar
2	Për dëmtim, çarje, ndotje trotuari	10 000 lekë	3 100 lekë / m ² trotuar të dëmtuar
3	Për dëmtim bordure	10 000 lekë	2 500 lekë / metër linear bordurë të dëmtuar
4	Për dëmtim, rrjetit të kanalizimeve, bllokim pusete	10 000 lekë	20 000-50.000 lekë / pusetë të dëmtuar
5	Për vjedhje të zgarës	20 000 lekë	2 500 mijë lekë / zgarë
6	Për vjedhje kapak pusete	10 000 lekë	3 000 mijë lekë / kapak pusete të vjedhur
7	Lidhjet e pamiratuara në rrjetin ajror	20 000 lekë	2 000 mijë lekë / lidhje
8	Dëmtimi i shtyllave	10 000 lekë	520 000 lekë / shtyllë të dëmtuar
9	Dëmtimi i ndriçuesve të qytetit	20 000 lekë	420 000 lekë / ndriçues të dëmtuar
10	Përdorimi i shtyllave si suport për reklamë	10 000 lekë	20 000 lekë /reklamë të ngjitur në shtyllë në mënyrë të paligjshme
11	Ndërhyrje në kuadrot e komandimit për ndriçimin publik	10 000 lekë	4 200 lekë / shtyllë ku është dëmtuar kuadri i komandimit
12	Lidhjet e pamiratuara në rrjetin	10 000 lekë	20 000 mijë lekë/ lidhje



	ajror		
13	Dëmtimi i rrjetit ajror nga punimet pa leje	10 000 lekë	5 200 lekë/ metër linear
14	Lidhjet e pamiratuara në tubacionet e ujit	10 000 lekë	2 300 lekë / metër linear ndërhyrje
15	Dëmtimi i pusetave të kanalizimit	5 000 lekë	5 000 lekë / copë
16	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	1 000 lekë / m ² - sipërfaqe të gjelbërt
17	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	6 300 lekë / m ² - sipërfaqe lule sezonale
18	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	3 900 lekë / shkurre dekorative në moshën 5 vjeç e poshtë
19	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	5 800 lekë/ shkurre dekorative në moshën 5-10 vjeç
20	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	18 900 lekë / pemë apo dru që dëmtohet deri në moshën 5 vjeçare
21	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	10 000 lekë	28 300 lekë / peme apo druri që dëmtohet deri në moshën 5-10 vjeçare
22	Gjoha për të gjitha kategoritë e dëmeve	20 000 lekë	150 000 lekë /palma
23	Ushtrim aktiviteti pa leje transporti: - Motokarro - Autovetura - Furgon, minibus - Mjete me tonazh të lartë	Në bazë të ligjit nr.8378, date 22.07.1998, i ndryshuar "Kodi Rrugor	
24	Mospajisje me leje veprimtarie për servise riparim për mjetet e transportit, imbarkimin e mjeteve te transportit të difektuara, shërbime në lyerje mjeteesh, shërbime lavazho, parkime, gomisteri, zdruktari e tërbime lavazh, parkime, gomisteri,	10 000-20 000 lekë	



	zdruckhtari etj.		
25	Mospajisje me leje për tregëtim gazetari etj.	5 000 lekë	
26	Mospajisje me leje për tregëtim e shërbime ambulatorë, auto, dyqane dhe rulote	5 000 - 10 000 lekë	
27	Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti “24-orësh”	10 000 lekë	
28	Mospajisje me leje për zënien e hapësirave publike: Reklama të zakonshme/elektronike	5000-10000 leke	
29	Mospajisje me leje për mjetet që transportojnë mbetje të ngurta në qytet dhe zonat turistike	10 000 - 30 000 lekë	
30	Për vendosjen e posterave pa leje	10 000 lekë	
31	Për çdo copë posteri në pemë pa leje	5 000 lekë	
32	Për çdo dëmtim të fasadës, vendosje tabelash, pankarta pa leje.	10 000 lekë	3 200 lekë/ m2 zhdëmtimin e fasadës së dëmtuar
33	Vendosje mbishkrimesh pa leje në hapësira publike	5 00 lekë/m ²	3 200 lekë/ m2 zhdëmtimin e fasadës së dëmtuar
34	Hedhje e mbeturinave jashtë vendeve të përcaktuara nga Bashkia Persona juridikë Persona fizik	10 000 lekë 500 - 1 000 lekë	
35	Lëvizja e kontenerëve të mbetjeve urbane nga vendi i miratuar nga Bashkia: Persona juridikë Persona fizik	10 000-20 000 lekë 500 - 1 000 lekë	
36	Për ndotje të hapësirës publike jashtë rrethimit të kantierit të	1. Për herë të parë 5000 lekë	



	ndërtimit nga inerte, apo material të tjera ndërtimore	2. Për raste të përsëritura 10 000 lekë	
37	Mosndërtim i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane nga subjektet e ndërtimit	20 .000 lekë	
38	Për rastet kur kamionët, të cilët transportojnë materiale ndërtimore, nuk janë mbuluar dhe që krijojnë ndotjen e hapësirave publike, gjatë transportimit	20 000 lekë	
39	Për hedhje mbeturinave ndërtimore jashtë territorit të përcaktuar për këtë qëllim nga Bashkia: Për shoqëritë e transportit	20 000 lekë për raste të përsëritura heqje të lejes së transportit	
40	Për të gjithë ata që bllokojnë kanalet kulluese apo vaditës me ndërtime të paligjshme të çfarëdo lloji	20 000 lekë	
41	Për mbrojtjen e mjedisit Mosdhënia e informacionit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve nga operatori, duke i shkarkuar në vende jo të caktuara nga Bashkia dhe në bazë të lejes mjedisore	20 000 lekë	

Sqarim: Në rastet e kundravajtjeve të qarkullimit rrugor nga kundravajtës të ndryshëm, gjobat do të vendosen nga Inspektorët e Policisë Bashkiake bazuar në Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 “ Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

> *Baza ligjore : Ligji Nr. 10279 datë 20.05.2010 “Përkundërvajtjet administrative” neni nr. 6, ligji nr. 8224 datë 15.05.1997 “ Për Policinë Bashkiake” i ndryshuar përkatësisht të neneve 3,4,6, ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “ Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

- Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjithë Drejtoritë dhe zyrat e Bashkisë Rrogozhinë dhe Institucionet në varësi të saj.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

**KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI**